

MUAJI SHEVAL

dobi, dispozita dhe urtësi



Agron Krasniqi




MUAJI SHEVAL

dobi, dispozita, urtësi

Falënderimi dhe lavdërimi i takojnë Allahut të Lartësuar, Zotit të botëve, paqja dhe lavdërimi i Tij qofshin për të Dërguarin Muhamed ﷺ. Kjo është një përmbledhje e disa dispozitave, dobive dhe urtësive të lidhura me muajin Sheval.

Lus Allahun e Lartësuar ta bëjë të dobishëm!





1


Muaji Sheval është muaj i cili vijon pas muajit Ramazan, gjegjësisht muaji i dhjetë sipas kalendarit hënor (hixhri).

2

Dita e parë e tij, është dita e Bajramit të Fitrit, festë kjo në të cilën muslimanët gëzojnë dhe festojnë mbarimin e muajit Ramazan duke shpresuar nga Allahu në këtë ditë feste shpërblimin e agjërimit dhe adhurimeve të tyre.

3

Është fillimi i muajve të Haxhit, e që janë: Shevali, Dhul Kadeja dhe Dhul Hixheja.





4

Në këtë muaj është e ligjshme kompensimi (kazaja) i itikafit, për atë që i ka ikur itikafi në muajin Ramazan për ndonjë arsye. I Dërguari i Allahut ﷺ në njërin prej viteve e la itikafin në muajin Ramazan për disa arsye, më pastaj e kreu atë në dhjetë ditë të muajit Sheval.

Në një transmetim qëndron se:

"i Dërguari ﷺ hyri në itikaf në dhjetë ditët e fundit të muajit Sheval".

Shënojnë Buhariu (2033, 2041) dhe Muslimi (1172)

Imam Maliku (179 h) në librin e tij "el Muvata" vendosi kapitullin: "Kompensimi (kazaja) i itikafit", pastaj nën të shënoi hadithin e përmendur më sipër.




5

Është e ligjshme për muslimanin agjërimi i 6 ditëve nga muaji Sheval, pas Ramazanit. Një gjë e tillë është sunet, e pëlqyer, jo obligim. Vlera e kësaj vepre është e madhe dhe shpërblimi për të është i shumtë, siç do të përmendim në vijim.

6

Kush agjëron gjashtë ditë nga muaji Sheval, pasi ta ketë agjëruar Ramazanin, i shkruhet atij agjërimi i një viti të plotë, siç është vërtetuar nga i Dërguari i Allahut ﷺ





7

Ebu Ejub el Ensari (Allahu qoftë i kënaqur me të) përcjellë nga i Dërguari i Allahut ﷺ të ketë thënë:

"Atij që e agjëron (muajin) Ramazan, pastaj e përcjellë atë duke agjëruar gjashtë ditë të muajit Sheval, do t'i konsiderohet sikur të agjërojë përjetësisht - tërë kohën".

Shënon Muslimi (1164)

Ky hadith është i saktë, e kanë saktësuar atë imamët: Abdullah ibn Mubareku (181 h), Muslimi (261 h) duke e shënuar atë në "Sahihun" e tij, Tirmidhiu (279 h), Ibn Huzejme (311 h), Ibn Hibani (354 h), Bejhakiu (458 h) e të tjerë.


Imam Ibn Mubareku (181 h) ka thënë: "Ai është i mirë (hasen)".



Imam Tirmidhiu (279 h) thotë: "Hadithi i Ebu Ejubit është i mirë, i saktë (hasenun sahih)".

Imam Bejhakiu (458 h) thotë: "Ky hadith është i saktë, i vërtetuar nga hadithi i Ebu Ejub el Ensariut".

Shih: "Sunenin e Tirmidhiut" (2/124),
"Marifetus Sunen" të Bejhakiut (3/450)





8

Bazuar në këtë hadith, shumë prej dijetarëve kanë rekomanduar agjërimin e gjashtë ditëve të Shevalit, prej tyre imamët: Shafiu (204 h), Ahmedi (241 h), Is'haku (238 h), po ashtu është transmetuar nga dy shokët e të Dërguarit ﷺ : Abdullah ibn Abasit dhe Ka'b el Ahbarit, (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) dhe ky njëherit është mendimi i Tavusit (110 h), Sha'biut (pas vitit 100 h), Mejmun ibn Mihranit (117 h), Abdullah ibn Mubarekut (181 h) e të tjerëve.

Ndërsa imamët: Ebu Hanife (150 h), Ebu Jusufi (182 h) dhe Maliku (179 h) e konsideruan një gjë të tillë të papëlqyer (mekruh), thanë se: është e papëlqyer, nga frika se mos njerëzit e konsiderojnë si obligim (farz) apo i shtojnë Ramazanit ditë që nuk janë të tij.


7



Imam Maliku (179 h) ka thënë: "Nuk kam parë ndokënd nga dijetarët t'i ketë agjëruar këto ditë dhe nuk më ka arritur kjo gjë nga ndonjëri prej selefëve, dhe se dijetarët e urrejnë këtë dhe frikësohen të jetë risi (bidat) dhe t'i ngjitet Ramazanit diç që nuk i përket atij..". "El Muvata" (1/311)

E sakta qëndron në mendimin e parë, pra, është sunet dhe e pëlqyer agjërimi i këtyre ditëve, ngase hadithet e transmetuara për këtë janë të sakta dhe të qarta në aludim, siç kemi sqaruar më lart.

Gjithashtu, frika se njerëzit mendojnë se është obligim apo se këto ditë mund t'i ngjiten Ramazanit, nuk janë argumente që një gjë e tillë mos të veprohet apo mos të jetë e pëlqyer.






Sidomos kur shtojmë faktin se dita e Bajramit është e ndaluar të agjërohet, andaj, ai i cili ha e pi ditën e Bajramit, pastaj agjëron këto ditë, vetëm se i ka ndarë ato nga Ramazani.

Imam Kesani (587 h) nga hanefitë, thotë: "Përcjellja e papëlqyer (e Ramazanit me këto 6 ditë të Shevalit) është të agjërojë ditën e Bajramit dhe pas saj të agjërojë 5 ditë, kurse nëse e prish ditën e Bajramit, pastaj agjëron pas saj 6 ditë, kjo nuk është e urryer (mekruh) porse është e pëlqyer dhe sunet".

"Bedai'us Sanai" (2/78)

Imam Neveviu (656 h) thotë: "Nëse suneti është vërtetuar, atëherë ai nuk lihet shkak përse e lënë atë disa, shumica, apo të gjithë njerëzit". "Sherh Sahih Muslim" (8/56)





Kurse përgjigjja ndaj imam Malikut, imam Ibn Abdulberr (463 h) duke e arsyetuar atë, thotë: "Imam Malikut nuk i ka arritur hadithi i Ebu Ejub el Ensariut..".

Ndërsa, imam Mutarrif ibn Abdullahu (220 h), nxënësi i imam Malikut, përcjellë se: "imam Maliku i agjëronte këto ditë më vete". Pra, i agjëronte ato, por nuk i shfaqte te njerëzit, duke u frikësuar se njerëzit injorantë e marrin këtë si obligim. Allahu e di më së miri.

Shih: "el Istidhker" (3/380), "Tefsiri i Kurtubiut" (2/332)



9

Thënia e të Dërguarit ﷺ: "...sikur të agjërojë përjetësisht", ka për qëllim: sikur të agjërojë një vit të plotë, ngase siç dihet tek Allahu i Lartësuar një e mirë shpërblehet me dhjetë sosh, siç thotë në Kuran, i Lartësuar qoftë: "**Kush bën një vepër të mirë, do të shpërblehet dhjetëfish**". El En'am, (160)

Pra, një ditë agjërimi është i barazvlershëm me dhjetë ditë shpërblim.

E muaji Ramazan është në shpërblim i barazvlershëm me (10) muaj, kurse agjërimi i (6) ditëve të Shevalit është i barazvlershëm me dy muaj (60 ditë) - sepse $6 \text{ ditë} \times 10 = 60 \text{ ditë}$ -, e që së bashku i bie një vit i plotë.



10

Kjo është sqaruar kështu në hadithin që përcjellë Theubani (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë:

"Agjërimi i muajit Ramazan është (në shpërblim) sa dhjetë muaj dhe agjërimi i gjashtë ditëve të muajit Sheval është sa dy muaj, e kjo është agjërimi i një viti".

Shënojnë: Nesaiu në "el Kubra" (2883, 2874),

Ibn Maxhe (1715), Ahmedi (22412), Darimiu (1796), Ibn Huzejme (2115) e të tjerë.

Zinxhiri i transmetimit të këtij hadithi është i saktë, e saktësuan atë imamët: Ebu Hatim er Razi (277 h), Ibn Huzejme (311 h) dhe Ibn Hibani (354 h). Shih: "Letaif el Mearif" (f. 220)



Në një transmetim të këtij hadithi, tek Ibn Maxhe (1715) qëndron:

"Kush agjëron gjashtë ditë pas Bajramit të Fitrit, do të jetë për të një vit i plotë, kush bën një vepër të mirë, do të shpërblehet dhjetëfish".

11

Thënia e të Dërguarit ﷺ : "Atij që e agjëron (muajin) Ramazan, pastaj e përcjellë atë duke agjëruar gjashtë ditë të muajit Sheval...", tregon se është kusht që së pari të kompletohet muaji Ramazan, pastaj gjashtë ditët e Shevalit, andaj, ai që ka borxh ndonjë ditë nga Ramazani, duhet t'i kompensojë ato, pastaj t'i agjërojë këto ditë në mënyrë që ta arrijë këtë shpërblim. Ky është mendimi më i saktë, Allahu e di më mirë.



12

Nëse dikujt i kanë ikur këto gjashtë ditë pa i agjëruar, shikohet në gjendjen e tij; nëse ka pasur arsye si: sëmundje, cikël menstrual, lehoni apo ndonjë arsye tjetër të ngjashme, shkaku i të cilave e ka vonuar agjërimin e borxhit të Ramazanit apo gjashtë ditët e Shevalit deri sa ka kaluar muaji, s'ka dyshim se i tilli e zë shpërblimin e veçantë të cekur në hadith, këtë dijetarët e kanë theksuar. Pra, edhe nëse i agjëron ato në muajin Dhul Kade, pas Shevalit.

Ndërsa, nëse s'ka pasur ndonjë arsye, i tilli nuk e arrin shpërblimin e cekur në hadith, sepse kjo gjë është sunet e që ka kaluar koha e caktuar e tij, mirëpo, nëse i agjëron ato, e arrin shpërblimin e agjërimin të përgjithshëm që ka çdo agjërim i rëndomtë vullnetar, jo atë të



veçantë të ardhur për gjashtë ditët e Shevalit.

Kështu është përgjigjur shejh Abdurrahman ibn Nasir es Si'di. Shih: "Fetvatë" e tij (24/194)

13

Këto gjashtë ditë kanë ardhur në hadith në formë të pacaktuar, që tregon se lejohet të agjërohen në fillim, në mes apo në fund të muajit Sheval.

Imam Abdullah ibn Mubareku (181 h) zgjodhi mendimin që këto ditë të agjërohen në fillim të muajit. Shih: "Sunenin e Tirmidhiut" (2/124)



14

Nuk është kusht të agjërohen të gjashtë ditët përnjëherë, në formë të njëpasnjëshme. Pra, lejohet të agjërohen të ndara.

Imam Abdullah ibn Mubareku (181 h) po ashtu thotë: "Nëse i agjëron gjashtë ditët e Shevalit të ndara, kjo është e lejuar". "Suneni i Tirmidhiut" (2/124)

15

Është e pëlqyer nxitimi në agjërimin e tyre, sepse kjo tregon vendosmëri e vullnet në kryerjen e adhurimeve, është argument se e do agjërimin dhe se robi nuk e di se çfarë pengese mund t'i ndodhë atij, gjë që mund ta ndalojë nga kryerja e kësaj vepre.



16

Lejohet bashkërendimi i nijeteve në agjërimin e këtyre ditëve, si: t'i agjërojë ato të hënen dhe të enjten, duke bërë nijet edhe për Sheval edhe për të takuar sunetin e të hënës dhe enjtes, apo mes tyre dhe ditëve të bardha.

Ndërkaq, nuk lejohet bashkërendimi i tyre me agjërim obligativ (farz), siç është kompensimi (kazaja) e Ramazanit.

17

Lejohet të bëhet nijeti për agjërim vullnetar (jo farz, apo borxh të Ramazanit) gjatë ditës, pra, edhe nëse nuk e ka bërë nijet paraprakisht gjatë natës, me kusht të mos ketë ngrënë asgjë atë ditë. Ky është mendimi i shumë prej sahabëve, prej tyre: Aliu, Ebu Derdaja, Ibn Abasi, Muadh ibn Xhebeli, Ebu Talha, etj. Shih: "Musanefin" e Abdurrezakut (4/272-274)





Ky është njëkohësisht mendimi i shumicës së dijetarëve.

Mirëpo, për të arritur shpërblimin e plotë të këtyre gjashtë ditëve, atëherë, duhet bërë nijetin gjatë natës, pra para se të hyjë dita, gjegjësisht agimi i mëngjesit. Imam Ahmedi (241 h) ka thënë: "Kush bën nijet të agjërojë agjërim vullnetar gjatë ditës, atij i shkruhet pjesa e mbetur e asaj dite, e nëse e bën nijetin gjatë natës, i shkruhet dita e plotë". "El Mugni" (4/342)



18

Koha e agjërimit të këtyre 6 ditëve fillon që nga dita e dytë e këtij muaji, pra menjëherë pas ditës së Fitër Bajramit. Edhe pse disa prej selefëve e urrenin të agjërohen menjëherë pas ditës së Bajramit, si: Imam Ma'mer ibn Rashid (153 h) dhe nxënësi i tij Abdurrezaku (211 h). Mirëpo, shumica e dijetarëve nuk e shohin të urryer një gjë të tillë.

Shih: "Musanefin" e Abdurrezakut (4/316), "Letaif el Mearif" (f. 219)


19

Urtësia pse këto ditë janë nga muaji Sheval, siç përmend imam Ibn Kajimi (751 h) qëndron në atë se këto janë si spastrim dhe plotësim për mangësitë që mund të kenë ndodhur gjatë agjërimit të Ramazanit, ato ngjajnë me sunetet pas



namazeve farz dhe me sexhden e harresës, të cilat i plotësojnë farzet, gjegjësisht gabimet dhe mangësitë e ndodhura në to. Shih: "el Menar el Munif" (f. 39) të Ibn Kajimit.

- 20 Vazhdimësia e agjërimit pas muajit Ramazan është shenjë e pranimit të agjërimit të Ramazanit, ngase vërtet, Allahu i Lartësuar kur e pranon veprën e një robi ia bën të mundur atij të veprojë ndonjë vepër tjetër të mirë, siç thonë disa: "shpërblimi i të mirës, një e mirë pas saj". "Letaif el Mearif" (f. 221)





21

Është e pëlqyer fejesa dhe martesë në muajin Sheval. Urvetu ibn Zubejri (Allahu e mëshiroftë!) përcjellë se Aisheja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë:

"I Dërguari i Allahut ﷺ bëri aktin e martesës me mua në muajin Sheval dhe më martoi po ashtu në muajin Sheval, e cila nga gratë e të Dërguarit ﷺ ishte më me fat tek ai sesa unë?!".

Urve thotë: "Aisheja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) e pëlqente që gratë të martohen në Sheval".

Shënon Muslimi (1423)



Këto ishin disa nga dobitë, dispozitat dhe urtësitë që kanë të bëjnë me muajin Sheval, lus Allahun e Lartësuar të na pranojë dhe ta bëjë të dobishëm, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të Dërguarin e Tij ﷺ.

MUAJI SHEVAL

dobi, dispozita dhe urtësi



Përgatiti

Agron Milazim Krasniqi



t.me/hoxheAgronKrasniqi